


Emigrimi drejt Bashkimit Evropian nga Ballkani Perëndimor 2020-2024



Sipas Eurostat, gjatë periudhës 2020-2024 nga Ballkani Perëndimor kanë marrë leje-qëndrim për herë të parë në BE **1.13 milionë** persona. Shqipëria kryeson me mbi 324 mijë leje-qëndrime, ndjekur nga Serbia me afërsisht 236 mijë. Shqipëria dhe Kosova kanë fluksin më të madh të emigrimit në BE, me 13% të popullsisë që ka marrë leje-qëndrime për herë të parë gjatë periudhës 2020-2024, ndërsa Mali i Zi ka nivelin më të ulët me vetëm 3% të popullsisë.


Figura 1. Gjithsej leje-qëndrimet e lëshuara për herë të parë nga shtetet e Bashkimit Evropian për shtetasit e Ballkanit Perëndimor (2020-2024)



Trendi i leje-qëndrimeve të lëshuara nga BE (2020-2024)

Leje-qëndrimet për qytetarët e Ballkanit Perëndimor në BE u rritën nga 2020 deri në 2023, por ranë në vitin 2024. Kosova shënoi rritje nga 32,134 leje në 2020 në 48,937 në 2023, duke u renditur ndër vendet me numrin më të lartë të lejeve, megjithëse kishte shifra më të ulëta se Shqipëria dhe Serbia.


Figura 2. Trendi i leje-qëndrimeve të lëshuara nga vendet e BE-së për shtetasit e Ballkanit Perëndimor (2020-2024)



Destinacionet kryesore të emigrimit nga Ballkani Perëndimor

Në vitin 2024, destinacioni kryesor i emigrimit të qytetarëve nga Shqipëria ishte Italia, e cila përfaqësonte 37% të gjithsej leje-qëndrimeve. Për të gjitha shtetet e tjera të Ballkanit Perëndimor, destinacioni kryesor ishte Gjermania. Ky shtet përfaqësonte 58% të gjithsej leje-qëndrimeve të lëshuara për qytetarët e Kosovës, 31% të qytetarëve të Serbisë, 37% të qytetarëve të Shqipërisë, 40% të qytetarëve të Malit të Zi, 47% të qytetarëve të Maqedonisë së Veriut dhe 33% të qytetarëve të Bosnjës dhe Hercegovinës.

Figura 3. Destinacionet me numrin më të lartë të lejeve të qëndrimit të lëshuara për qytetarët e Ballkanit Perëndimor gjatë vitit 2024




Leje-qëndrimet gjatë vitit 2024 dhe arsyet e lëshimit të tyre

Sipas numrit të leje-qëndrimeve të lëshuara nga shtetet e BE-së, prin Shqipëria (66,193) ndjekur nga Serbia (46,563), Bosnja dhe Hercegovina (39,227), Kosova (38,770), Maqedonia e Veriut (26,826) dhe Mali i Zi (3,281).


Mbi gjysma e të gjitha leje-qëndrimeve për qytetarët e Kosovës dhe Shqipërisë dhe gati gjysma për qytetarët e Maqedonisë së Veriut janë lëshuar për arsye të bashkimit familjar, për dallim nga Serbia, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi ku arsyeja kryesore është punësimi.

Figura 4. Gjithsej leje-qëndrimet e lëshuara për herë të parë nga shtetet e Bashkimit Evropian për shtetasit e Ballkanit Perëndimor (2024)



Burimi: Eurostat

Figura 5. Arsyet e lëshimit të leje-qëndrimeve nga shtetet e Bashkimit Evropian për shtetasit e Ballkanit Perëndimor (2024)



Burimi: Eurostat